

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
IDEA & MONEY SH.P.K

Sot në Tiranë më 18.04.2019, me vullnet të plotë, të lirë dhe të pavesuar, themeluesit e mëposhtëm:

- **Ndokë Kola**, lindur në Brashtë, Shkodër, më 18.01.1977, me nr. Leternjoftimi 033103461 dhe nr.Personal H70118053F;
- **Saimir Mella**, lindur në Paç, Tropojë më 30.03.1987, me nr. Pasaporte BA8335602 dhe nr.Personal I70330141J

Me dëshirën për te krijuar një shoqëri në Shqipëri, bazuar në Ligjin Nr. 9901 Dt. 14.04.2008 te Republikës se Shqipërisë “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), shprehin vullnetin e tyre duke deklaruar themelimin e “Shoqërisë me përgjegjësisë të kufizuar Idea & Money” sipas këtij Akt Themelimi.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Idea & Money, me poshtë e quajtur Idea & Money shpk ose shoqëria (*brevetatis causa*), kriohet me ortakëri, specifisht 2 ortakë, që janë edhe themeluesit e saj, në formën e parashikuar nga ligji si shpk. Idea & Money shpk është person juridik i te drejtës shqiptare dhe për rregullimin e veprimitarisë se saj zbaton statutin, rregulloret e brendshme dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 1

Selia

1. Selia e Idea & Money shpk është e vendosur në Tiranë në adresën adresën: Rruga “Margarita Tutulani”, nr.6 përballë gjimnazit Petro Nini Luarasi, Tiranë.

Neni 2

Qëllimi dhe Fusha e Veprimitarisë

1. Idea& Money shpk ka qëllim të zhvillojë dhe përhapë shërbimet komisionere, transfertat e parave, këmbimin valutor të parave si dhe kryerjen e veprimitarisë së agjentit komisioner.
2. Fusha e veprimitarisë së Idea & Money shpk do të shtrihet:
 - a) në fushën e shërbimeve të ndryshme komisionere,
 - b) veprimitarinë e agjentit për transfertë parash,

- c) veprimtarinë e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jobankë, veprimtarinë e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretë në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jobankë,
- d) veprimtarinë e agjentit komisioner,
- e) shërbimet Unionet – Western Union,
- f) Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, shitblerje te pasurive te lujtshme apo te palujtshme , hipotikime financiare dhe kreditimi, te jape garanci reale dhe personale per te tretet, te bleje shesë dhe marrë me qera ndërmarrje degë ndërmarrjesh si dhe të marrë interesa dhe të marrë pjesë në shoqëri, ente, konsorce te themeluara ose duke themeluar me objekt te njëjtë ose të afërt me qëllim te realizojë objektin e shoqërisë,
- g) Shoqeria mund te kryeje veprimitari te tjera te nevojshme ose te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise,
- h) Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet mbi pasurit e lujtshme dhe te palujtshme, financiare, tregtare, te lidhi kontrata bilaterale aktive dhe pasive me Institute Krediti te autorizuara nga ligji edhe me firma Private , te japi garanci reale per te tretet dhe ghjithcka qe eshte e nevojshme per arrijet e qellimit te shoqerise.

Per te vetmin qellim te arritjes se objektit te lartepermendur, shoqeria mund te bleje interesa, aksione ,pjesemarrje te kapitalit, ne shoqeri te tjera,konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngjashme apo analoge me te vetin dhe te kryeje te gjitha veprimete komericiale industrial dhe financiare.

Ne vecanti , shoqeria mund te marre ne pronesi, uzufrukt ose me qera , kompani ose dege kompanish qe operojne ne fushen e nje ose me shume prej veprimtarive te mesiperme.Shoqeria mund te jape gjithashtu garanci, garanci mbi kredite dhe depozittat, te lere peng te mira dhe vlera te tundeshme, te vendose garanci hipotekore mbi te mirat e patundeshme dhe te tundeshme te regjistruala dhe te vendose ne per gjithesi cdo garanci te mundeshme reale dhe personale. Te njejtat garanci mund te vihen dhe ne interes te subjekteve te lidhura me te nga raporte ose pjesemarrje, me perjashtim te te tjereve. Shoqeria mund te tregtoje artikuj industrial, kancelari etj; Te hape dhe menaxhoje bare, restorante, fastfood, pasticerietj.

Nen 3

Kohëzgjatja

1. Idea & Money shpk themelohet për një kohë të pacaktuar.

Neni 4

Financimet dhe burimet e te ardhurave

1. Kapitali i shoqërisë është 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) leke, i marrë përsipër dhe i nënshkruar nga ortakët. Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuota me vlera nominale secila prej 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, që përbëjnë dhe 100% të kapitalit të shoqërisë.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj Idea & Money shpk do te përdorë si burime financiare:

- Kontributi në vlerën 750 000(shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë i ortakut **Ndokë Kola**;
- Kontributi në vlerën 750 000(shtatëqind e pesëdhjetë mijë) leke i ortakut **Saimir Mella**;
- Çdo burim të ardhurash të ligjshëm, i cili shërben në realizimin e qëllimit të shoqërisë.

2. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimeve ose e përfitimit finansiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e shoqërisë ndaj personave që nuk janë subjekte të Statutit ose Aktit të Themelimit, përvèç detyrimeve në formën e pagesave për punë të kryera në favor të shoqërisë, të rrrogave që rrjedhin nga kontrata e punës, shpërblimeve dhe kompensimeve nëse është rasti, gjithashtu edhe për mbulimin e shpenzimeve te kryera me porosi dhe për llogari të shoqërisë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 5

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë

1. Përfaqësues ligjor dhe administratori i kësaj shoqërie është **Rudina Cane**, e datëlindjes 18.05.1989, lindur në Korçë, me nr.Pasaporte BR6148577 dhe nr.Personal I95518029L.

2. Administratori ka kompetencë të përfaqësoje shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Administratori kryen gjatë veprimtarisë së tij ato detyra që ai i gjuxon të nevojshme që janë për interesat e shoqërisë dhe sigurimit të fitimit. Gjithashtu, duhet të dokumentojë hollësisht të gjithë veprimtarinë e tij.

Neni 6

1. Personat e autorizuar, së bashku apo veç e veç, për të ndjekur procedurat e nevojshme për regjistrimin e Idia & Many shpk pranë organeve përkatëse janë:

1. Ndokë Kola;

2. Saimir Mella;
3. Rudina Cane

Neni 7

Veprimtaria Ekonomiko- Financiare

Në marrëdhënie financiare shoqëria vepron me monedhën vendase, Lekë. Ajo ka të drejtë të përdorë edhe valutën e huaj konform legjislacionit në fuqi.

Veprimtaria ekonomiko- financiare e shoqërisë mbyllt me datë 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, përveç rasteve të urdhrave të veçantë që jepen nga asambleja e ortakëve. Në fund të periudhës ushtrimore nxirren pasqyrat e gjendjes financiare të shoqërisë (bilanci) dhe rezultati ekonomik (fitim/humbja) bazuar në rregullat e mbajtjes së kontabilitetit nga shoqëritë private të përcaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal.

Neni 8

Fitimi/ Humbja

Fitimi, përcaktimi dhe miratimi i tij bëhet nga asambleja, e cila pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së tij përcakton dhe pjesën e secilit. Fitimi që do të shpërndahet, përbëhet nga fitimi i vtitit finanziar, të cilit i janë zbritur shumat për rezervat e nevojshme si dhe i janë zbritur ose shtuar humbjet/fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Të punësuarit nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit dhe nuk është e nevojshme të informohen për madhësinë e tij.

Akti i themelimit u përpilua në 4 (katër) kopje me vlerë të barabartë, për tiu shpërndarë organeve kompetente, ortakëve dhe mbajtje dokumentacioni për Idea&Money shpk.

THEMELUES

Ndokë Kola

Ndokë Kola

Omer Raxha

THEMELUES

Saimir Mella

Saimir Mella

S. Mella